



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
URDHRI I PSIKOLOGUT
KËSHILLI KOMBËTAR



Tiranë, më 26/05/2025

VENDIM

Nr.14, datë 26.05.2025

Në mbështetje të ligjit 40/2016 “Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”, **Këshilli Kombëtar**, në lidhje me kandidaturat për organet drejtuese të Urdhrit të Psikologut


VENDOSI:

1.Të miratojë me 9 (nëntë) vota pro, se kandidatura e Z. Arjet Pervizi nuk plotëson kriteret ligjore për vijimin e kandidimit në kategorinë Pedagogë mbështetur në arsyetimin se:

Kandidati nuk plotëson kriterin specifik për kategorinë e zgjedhur për kandidim, pasi aktualisht nuk e provon me dokumentacion që të jetë i punësuar në një institucion të Arsimit të Lartë. Neni 16, pika c) përcakton qartë se për këtë kategori mund të kandidojnë psikologët që kanë mbi 5 vjet eksperiencë pune në profesion dhe që aktualisht “punojnë në institucione të arsimit të lartë”. Po kështu Z.Pervizi nuk ka as gradën shkencore bazuar në nenin 16, shkronja c, ligji 40/2016 “Për urdhrin e psikologut në Republikën e Shqipërisë” i cili përcakton se kandidati nga kjo fushë duhet të zotërojë minimalisht gradën shkencore “Doktor Shkencash”.

PRESIDENTE E URDHRI
Dr.Valbona TRESKA

SEKRETARE
Arlinda KËRÇI



Blv. Gjergj Fishta, Ndërtesa nr. 26, kati II, Ap.9, Tiranë
email: sekretaria@urdhriipsikologut.al, Tel.: 0035542209927